

[Data 27/07/2023]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIME TË INTEGRUARA SIGURIE PËR GODINAT, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARASHKOLLOR E SHKOLLOR DHE INSTITUCIONET E TJERA TË BASHKISË TIRANË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35125300-2 Kamera sigurie; 35121700-5 Sisteme alarmi; 45312100-8 Instalime sistemesh për alarm në rast zjarri; 45312200-9 Instalime sistemesh për alarm në rast vjedhje; 79711000-1 Shërbime të monitorimit të sistemit të alarmit; 31625200-5 Sisteme alarmi anti-zjarr; 31630000-1 Sisteme alarmi anti-vjedhje; 75240000-0 Shërbimet e sigurisë, ligjit dhe rendit publik

Vlera e Fondit Limit: 471.152.880 (katërqind e shtatëdhjetë e një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 126 datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023” (i ndryshuar).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur (mbi kufirin e lartë monetar)” - “Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik”

AK arsyeton se: Qëllimi është vendosja e kushteve të njëjta për lidhjen e kontratave, gjatë periudhës kohore të marrëveshjes kuadër. Për arsye teknike dhe organizative, realizmi nga operatorë ekonomikë të ndryshëm nuk është i favorshëm, duke i shkaktuar vështirësi autoritetit kontraktor dhe kosto shtesë (të tilla si, mospërputhje e teknologjive të pajisjeve teknike të kërkuara për realizmin e këtij shërbimi nëpërmjet një platforme të vetme menaxhimi (referuar kërkesave teknike), kjo mospërputhje do vështirësonte menaxhimin, përdorimin, funksionimin, efincencën e të gjithë sistemit në tërësinë e tij dhe realizimin e kontratës nëse do të ofrohej nga operatorë ekonomikë të ndryshëm).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, aparatave dhe pajisjeve të lidhura me shërbimin e kërkuar, specifikimeve teknike/Termave

të Referencës, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet në një lot të vetëm, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK. Të gjithë zërat e shërbimit, aparaturave e pajisjeve që do të shërbejnë për instalimin, konfigurimin dhe zhvillimin e proceseve sipas kërkesave të AK janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, pra janë të gjithë si një komponent i vetëm në funksion të njëra tjetrës. Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë krijimin e një sistemi sigurie i integruar në një platformën menaxhimi shërbimesh (sisteme alarmi, reagim me grupe të gatshme, zjarri, kamera sigurie), ku për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të implementojë, instalojë dhe konfigurojë të gjithë elementët e nevojshëm për të arritur rezultatin e kërkuar.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë "1.3.A" konform Ligjit Nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të drejtuesit teknik për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë "1.3.A", konform Ligjit Nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;" Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2021, 2022) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që

shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001 për sistemin menaxhimin e cilësisë;
- b) ISO 14001 për menaxhimin e mjedisit;
- c) OHSAS 18001-2007 / ose SSH 45001-2018, për menaxhimin të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- d) ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: *Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:*

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*
- b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*
- c) *kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Nisur nga proceset e punës kritike, rendësisë së shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtesi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara, konkretisht:

a) ISO 9001 për sistemin menaxhimin e cilësisë;

Argumentimi: ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

b) ISO 14001 për menaxhimin e mjedisit;

Argumentimi: Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, **përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.**

c) OHSAS 18001-2007 / ose SSH 45001-2018, për menaxhimin të sigurisë dhe shëndetit në punë;

Argumentimi: Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Sistemi i

menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, **përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.**

e) ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Argumentimi: ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me: - mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik. - aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë. - aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive. - aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive. Referuar sa më sipër cituar, ky standard lidhet drejtpërdrejt me shërbimin e kërkuar. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, suporton dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria dhe transparenca. Referuar sa më sipër, disponueshmëria e certifikatës ISO 27001, parë kjo në raport me natyrën e furnizimeve dhe shërbimeve të kërkuara, ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese dhe trajtimin e informacionit konfidencial gjatë implementimit të saj, është një kërkesë në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga Autoriteti Kontraktor. Dhe është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi për sistemin e kamerave dhe programin monitorit të kamerave, sistemin e alarmit dhe të programit software për monitorimin e alarmeve, ose nga distributori i autorizuar për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të paraqesë dokumenta në mënyrë që të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit të këtyre produkteve ku të përcaktohen dhe kontaktet e prodhuesit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme në rast verifikimi nga ana e AK.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për pajisjet, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi garanton dhe jep siguri për mirëfunksionimin dhe përmbushjen e qëllimit të tyre sipas ToR. Gjithashtu, përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, garanton se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve që do të instalohen. Kjo garanton që pajisjet/ sistemet që kërkohen të implementohen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhuesi të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe instalimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve në kushtet e garancisë dhe pas saj.

Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për pajisjet e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e

operatorëve ekonomikë ofertues për ofrimin e shërbimit cilesor, brenda afateve dhe parametrave të kerkuara.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit/ distributorit të autorizuar është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kerkojë garanci mbi:

-Cilesinë e shërbimeve dhe pajisjeve që do të vendosen nga OE për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. .

-Përfshirjen e vet shërbimeve dhe suportit të prodhuesit apo rishitesit/partnerit të autorizuar në këtë kontratë.

-Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit.

-Përmes regjistrimit të investimit dhe klientit në databazen e prodhuesit, përfitim e mëvonshëm potencial të shërbimeve të konsulencës apo suportit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit Nr. 9918 datë 19/05/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me zonë mbulimi Qarku i Tiranës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, si dhe të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Kjo kërkesë është vendosur konform ligjit Nr. 9918 datë 19/05/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". AKEP është institucioni i vetëm i pavarur i cili licenson dhe monitoron të gjithë operatorët në Republikën e Shqipërisë. AKEP rezervon të drejtën të autorizojë operatorët për shërbimet e ndryshme që ata ofrojnë në përputhje me standartet si dhe monitoron të gjithë infrastrukturën e cdo operatori i cili e ka të detyrueshme paraqitjen e shtrirjes së rrjetit të tij pranë AKEP sipas teknologjisë përkatëse që operatori disponon.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kërkesa për paraqitjen e Autorizimit të lëshuar nga AKEP, është e domosdoshme pasi tregon që operatorët ekonomikë kanë zonë mbulimi frekuencash radiokomunikim, radioalarm mbi të gjitha objektet që do të ruhen me punonjesit e shërbimit të SHPSF.

2.3.5 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë qendër kontrolli në Qarkun Tiranë, kategoria 1.3.A. Kjo do të provohet nëpërmjet paraqitjes së Akt Miratim të lëshuar nga DVP Tiranë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014, 'Për shërbimin privat të sigurisë fizike", të ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike", si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Duke provuar me ane të këtij kriteri se disponon Qender Kontrolli për monitorimin sipas objektit të kontratës që prokurohet.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim Performance lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për vitin 2022, kategoria 1.3.A, konform ligjit nr.75/2014 dhe akteve nënligjore në fuqi për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike përmes të cilit të provohet që operatori ekonomik disponon:

- a) Jo më pak se 26 punonjës shërbimi, nga të cilët:
 - Përgjegjës shërbimi 1 punonjës të kategorisë 1.3.A
 - Operatori i kontrollit 5 punonjës të kategorisë 1.3.A
 - Punonjës për verifikimin e sinjaleve të alarmit 10 grupe verifikues sinjalesh alarmi punonjës të kategorisë 1.3.A (10 grupe të gatshme nga 2 persona në grup)
- b) Se subjekti nuk ka masa administrative për shoqërinë, për titullar subjekti, për drejtuesin teknik, gjatë ushtrimit të aktivitetit për vitin 2022 (konform ligjit nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", Udhëzim Ministri i Brendshëm Nr 130, datë 05.03.2018. "Për funksionimin e Shërbimit privat të sigurisë fizike".

Argumentimi: AK nëpërmjet këtij kriteri kërkon që OE ofertues që të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses të ketë performancë të mirë dhe ky kriter i jep sigurinë AK që OE ofertues ka aftësitë organizative dhe reputacionin e duhur për realizimin e kontratës objekt prokurimi, konform ligjit nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.30, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit privat të sigurisë fizike", bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe Neni 41 pika 4 "Kontratat e shërbimeve", e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kërkesa që OE të vërtetojë se nuk ka patur ngjarje gjatë afatit të përcaktuar, i jep besueshmërinë dhe garancinë AK se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën dhe se objekti i kontratës së prokuruar do të realizohet me sukses.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf të specializuar dhe certifikuar për lejimin e ushtrimit të profesionit të punonjësit të shërbimit të kategorisë 1.3 A, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi certifikatat për punonjësit e shërbimit të sigurisë dhe certifikatat për trajnimin e specializuar (të vlefshme), lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas Ligjit 75/2014 për SHPSF dhe Udhëzimit 130/05.03.2018 për SHPSF dhe të figurojnë në listpagesa për periudhën e kërkuar, si më poshtë:

- të paktën 1 punonjës Përgjegjës shërbimi (pajisur me certifikata trajnimi speciale sipas Udhëzimit 130/05.03.2018 për SHPSF)
- të paktën 5 punonjës Operatori i Kontrollit (pajisur me certifikata trajnimi speciale sipas Udhëzimit 130/05.03.2018 për SHPSF),
- 20 Punonjës për verifikimin e sinjaleve të alarmit 10 grupe (10 grupe të gatshme= 2 persona/ grup), pajisur me certifikata trajnimi speciale sipas Udhëzimit 130/05.03.2018 për SHPSF.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 77 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar neni 41, pika 4, germa "a", "b" dhe "c", i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë dëshmi për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a. licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

- b. një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c. fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin teknik dhe të figurojnë në listpagesa për periudhën e kërkuar, si më poshtë:

- a. Të paktën 6 (gjashtë) punonjës të deklaruar si teknik paisjesh transmetuese dhe të pajisur me certifikatën e sigurimit teknik;
- b. Të paktën 4 (katër) punonjës të deklaruar si specialist i rrjetit kompjuterik dhe të pajisur me certifikatën e sigurimit teknik;

Argumentimi: Kriteri është hartuar në përputhje me Nenin 41-Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve, të VKM nr. 285, date 19/05/2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; Në nenin 9 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Formimi i punëmarrësve” Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie.

Në nenin 7 të ligjit nr.13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse. Kjo kërkesë është hartuar në përputhje me qëllimin dhe fazat e procedurës.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1) Të paktën 1 (një) Inxhinier Kompjuterik, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa për “1 (një) Inxhinier Kompjuterik... bazohet në nevojën për krijimin e një rrjeti të integruar monitorimi që do të përfshijë dhe instalimin, vënien në punë, koordinimin dhe mirëmbajtjen e programeve të posacme të monitorimit, alarmeve etj.

Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i shërbimeve të kërkuara dhe Specifikimet teknike për t’u prokuruar, kërkesa prej të paktën 1 (nje) Inxhinierë të diplomuar në profilin Kompjuterik, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke qenë se profili i inxhinierit të kërkuar është i domosdoshëm për realizimin e shërbimeve të kontratës dhe do të merret me konfigurimet e sistemeve me sallën e kontrollit.

- 2) Të paktën 2 (dy) Inxhinier elektronik ose informatik, për të cilët operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojnë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i shërbimeve të kërkuara dhe Specifikimet teknike për t’u prokuruar, kërkesa prej të paktën 2 (dy) Inxhinierë të diplomuar në profilin Elektronik ose Inxhinieri Informatik, janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke qenë se profili i inxhinierëve të kërkuar është i domosdoshëm për realizimin e shërbimeve të kontratës. Kërkesa për 2 inxhinier elektronik bazohet në VKM 514 date 20.09.2017 Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar” i cili për profesionin Inxhinier Elektronik parashikon se:

Inxhinierët elektronike kryejnë studime, dizajnojnë ose drejtojnë funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparojnë sistemet elektronike dhe studiojnë e këshillojnë mbi aspektet teknologjike të materialeve, produkteve apo proceseve inxhinierike elektronike. Ndër detyrat e tyre kryesore përfshihen:

- a) *Këshillojnë mbi ose dizajnojnë pajisje elektronike ose komponentë, qarqe, gjysmë-përçues dhe sisteme;*
 - b) *Specifikojnë prodhimin dhe metodat e instalimit, materialet dhe standardet e cilësisë dhe drejtojnë prodhimin ose punën e instalimit të produkteve dhe sistemeve elektronike*
 - c) *Përcaktojnë standardet dhe procedurat e kontrollit për të siguruar funksionim eficient dhe të sigurtë të sistemeve elektronike, motorëve dhe pajisjeve;*
 - d) *Organizojnë dhe drejtojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve dhe pajisjeve elektronike ekzistuese;*
- 3) Të paktën 1 (një) TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i shërbimeve të kërkuara dhe Specifikimet teknike për t’u prokuruar, kërkesa prej të paktën 1 (një) TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi), justifikohet me faktin se për realizimin me sukses të kontratës do të jete e nevojshme të sigurohet instalimi dhe funksionaliteti 24/7 i sistemeve të integruara të sigurojë dhe do të ofrojë ekspertizën e nevojshme për mirëmbajtjen e të gjithë rrjeteve. Kërkesa për një TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) është hartuar duke marrë në konsideratë natyrën e këtij tenderi pasi ky specialist është i nevojshëm për studimin, analizimin dhe rekomandimin e strategjive për zhvillimin e rrjeteve, konfigurimi i rrjeteve hardware dhe software, monitorimi i problemeve të krijuara, si dhe optimizimi i performancës së tyre etj.

- 4) Të paktën 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i shërbimeve të kërkuara dhe Specifikimet teknike për t’u prokuruar, kërkesa prej të paktën 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni, justifikohet me faktin se për realizimin me sukses të kontrates do të jete e nevojshme të sigurohet mbajtja e efience e sistemeve të transmetimit të alarmeve pa problem. Kërkesa për 1 Inxhinier Telekomunikacioni bazohet në VKM 514 date 20.09.2017 Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesionevë (LKP), të rishikuar” i cili për profesionin Inxhinier Telekomunikacioni parashikon se:

- Inxhinierët e telekomunikacionit kryejnë kërkime, dizajnojnë dhe drejtojnë funksionimin e konstruksionit, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve dhe pajisjeve të telekomunikacionit.
- Studiojnë dhe këshillojnë për aspektet teknologjike të materialeve inxhinierike, produkteve apo proceseve të telekomunikacionit.
- Zhvillojnë kërkime dhe zhvillojnë sistemet/pajisjet e telekomunikacionit;
- Këshillojnë, dizajnojnë, instalojnë sistemet/ pajisjet e telekomunikacionit (komponentët, sistemet, pajisjet dhe qendrat e shpërndarjes);
- Specifikojnë produktin, instalimin e metodave, materialeve, cilësinë e tij etj.;
- Planifikojnë, dizajnojnë, zbatojnë rrjete komunikimi bazuar në fibra optike, komunikime wireless, radio, TV etj.; Menaxhojnë projekte teknike lidhur me implementim platformash të reja, zgjerim kapaciteti të atyre ekzistuese etj.;

5) Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar në Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Projekt Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute (P M I) ose ekuivalente; për të cilin operatori ekonomik të paraqesi çertifikatën përkatëse dhe të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i kontrates Menaxheri i Projektit do të jetë personi që do të koordinojë implementimin me sukses të të gjithë kontratës.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë që ka ky projekt që reflektohet jo vetëm në vlerën por dhe kohështrirjen prej 3 vitesh të shërbimit, për Autoritetin Kontraktor është shumë e rëndësishme që O.E të ketë në staf persona të aftë për ta menaxhuar projektin në tërësi. Pra personi i pajisur dhe certifikuar si Menaxher Projekti si më sipër do të jetë pika kyçe që do të koordinojë të gjithë projektin dhe do të mbajë kontaktet me AK.

Përcaktimi i kriterit për një menaxher projekti të çertifikuar, OE garanton AK-në se:

- disponon kapacitetet e duhura në lidhje me menaxhimin e projektit në tërësinë e vet, në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore të përfshira, ndarjen e saktë dhe në kohën e duhur të detyrave, prioritizimin e detyrave, zgjidhjen e situatave kritike ose pothuajse kritike, vendimarrjen e duhur dhe të saktë, menaxhimin e marrëdhënieve mes palëve të përfshira, ndjekjen e saktë të periudhës së implementimit të sistemit, menaxhimin e kërkesave për ndryshime. Sa më sipër, përmes standardeve dhe praktikave më të mira të kthyer në standarde të njohura dhe të ndjekura botërisht
- garanton vazhdimësinë e projekteve dhe kontratave të punës, duke siguruar për punonjësit më të kualifikuar vendosjen e marrëdhënieve të besueshme të punës.

- vlerëson rendësinë e projektit në fjalë duke angazhuar punonjësit më të kualifikuar, rrit performancën e projektit, rrit vlerën e investimit njerëzor në projekt dhe në këtë mënyrë siguron suksesin e përbashkët.

Certifikata Prince2, konfirmon njohuri të thellë të metodologjisë PRINCE2, gatishmërinë për të punuar në një ekip si specialist teknik, menaxher i projektit ose ndihmësi i tij. Punonjësi i certifikuar në menaxhimin e projektit, është përgjegjës për sigurimin e cilësisë së projektit, për shkallën që duhet arritur për të plotësuar kërkesat e projektit në mënyrë të plotë :

- Menaxheri i projektit është përgjegjës për garantimin e cilësisë në formë preventive përmes kontrollit.
- Është përgjegjës për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë , në formë të parashikueshme dhe të përsëritshme.
- Kryen verifikim të cilësisë përpara dorëzimit të shërbimit dhe sigurim të cilësisë përmes përmirësimit të vazhdueshëm.
- Bën të mundur dallimin e qartë mes nivelit të shërbimit (pa e lidhur me kërkesat) dhe cilësisë (që është përmbushja e plotë e kërkesave)

- 6) Të paktën 1 (një) ekspert zjarrfikës të certifikuar për “Studimin dhe përgatitjen e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri në ndërtesa të çdo lloji”, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi certifikatën përkatëse dhe të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i prokurimit, dhe zerat e shërbimeve eksperti zjarrfikës do të jete personi i ngarkuar me mbikqyrjen e instalimeve dhe funksionimin e sistemeve kundra zjarrit. Kërkesa e mësipërme është vendosur pasi në procesin e implementimit të sistemeve kundra Zjarrit dhe përshtatjeve të tyre në objekte, është e nevojshme prania e një eksperti zjarrfikës për mbrojtjen kundër zjarrit i trajnuar.

- 7) Të paktën 10 (dhjetë) punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemit të alarmeve dhe sistemit të kamerave, certifikata këto për montimin dhe implementimin e sistemeve të alarmit dhe sistemit të kamerave, për të cilët operatori ekonomik të paraqesi certifikatat përkatëse të punonjësve dhe të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nisur nga objekti i prokurimit, dhe zërat e shërbimeve punonjësit e certifikuar për sisteme alarmi nga kompania prodhuese do të jenë personat që do të anagzhohen drejtëpërdrejtë në instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të alarmit. Certifikimi nga kompania prodhuese për produktin e ofertuar në funksion të shërbimit respektiv, siguron që instalimet dhe konfigurimet e operatorit ekonomik dhe stafit të tij të kryhen nga specialistë të certifikuar për teknologjinë respektive, duke pasur parasysh faktin që teknologji të ndryshme kanë specifika të ndryshme dhe kërkojnë konfigurime të ndryshme. Kriteri i vendosur është përcaktuar për të garantuar se OE ka kapacitetet dhe burimet njerëzore për implementimin e projektit me sukses dhe në afat. Gjithashtu dhe për të ofruar mirëmbajtje të pajisjeve, suport dhe zgjidhje të problemeve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, në mënyrë të shpejtë dhe efektive, për të cilat shfaqet e nevojshme disponueshmëria e stafit teknik të kualifikuar nga prodhuesi i këtyre pajisjeve, referuar të cilave do të ofrohet dhe sigurohet vijueshmëria e shërbimit të kërkuar.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor në cdo rast është vërtetimi se subjektet ofertues zoterojnë staf të kualifikuar teknik për realizimin e objektit të prokurimit

- 8) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Argumentimi: *Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Nisur nga objekti i prokurimit, dhe zërat e shërbimeve Punonjësi përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune i jep garanci autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka staf te specializuar dhe te kualifikuar per zbatimin e rregullave te sigurise ne pune duke marre ne konsiderate se ne kete procedure do te kete instalime dhe mirembajtje te vazhdueshme.*

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.7/8/9, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikatat/ diplomat/ vërtetimet përkatëse;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ të specializuar dhe profilin e punonjësve në kategoritë e sipërkërkuara;
- Listëpagesat sipas formularit e Sig 025 për 3 muajt e fundit të deklaruar ku të përfshihen punonjësit e kërkuar në kategoritë e sipërkërkuara.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, si dhe për të provuar se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore, profesionale e teknike, për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie dhe implementimin me sukses të projektit referuar termave, kërkesave funksionale e teknike, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 50 (pesëdhjetë) persona/ punonjës të specializuar/të kualifikuar, për periudhën 3-muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore (e-Sig01/a) ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e kërkuar;

- Listëpagesat sipas formularit e Sig 025 për periudhën e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim: *Për përmbushjen e kriterit 2.3.7/8/9/10, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:*

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kërkesa për staf është minimalisht e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar, prania e stafit teknik të diplomuar sipas kërkesave të këtij kriteri, i jep siguri AK se Operatorit Ekonomik ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e integritetit, konfigurimeve, testeve dhe shërbimeve që do të mundësohen nëpërmjet kësaj kontrate (dhe jo vetëm).

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës bazuar në analizën e kryer për kërkesën për punonjës të specializuar/të kualifikuar referuar kriterit 2.3.7/8/9.

Numri i personave të stafit të kërkuar është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë projekt.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 6 automjete dhe 4 Motora për verifikimin e sinjaleve të alarmit.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre mjeteve, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Në rastet kur mjetet janë në pronësi:

- Certifikat Pronësie,
- Leje Qarkullimi,
- Siguracion,
- Kontroll Teknik,
- Taksë Vjetore.

Në rastet kur mjetet janë me qera:

- Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e shërbimit,
- Certifikat Pronësie,
- Leje Qarkullimi,
- Siguracion,

- Kontroll Tenik,
- Taksë Vjetore.

Në rastin kur automjeti është marrë me qira, Leja e Qarkullimit duhet të shoqerohet edhe me Kontratën noteriale të marrjes me qira, ku të jetë përcaktuar afati dhe qellimi i marrjes me qira.

Shënim: Për përmbushjen e kriterit 2.3.11, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë mjetet e nevojshme në dispozicion për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës, duke mbuluar me to të gjitha zonat e Bashkisë së Tiranës ku grupet e verifikuesve të sinjaleve do të jenë në gadishmëri për zbatim të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ specialistët e fushës/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të AK-së, për “Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës, specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucionet e tjera të Bashkisë Tiranë”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” dhe i bashkangjiten Dokumentave Standarte të Tenderit.

Objektivi/ Qëllimi i projektit: Mbulimi me një sistem të integruar sigurie që do të mundësojë instalimin e kamerave CCTV, menaxhimin e ruajtjes së pamjeve filmike të monitorimit nepermjet paisjeve elektronike rregjistuese të kamerave CCTV, instalimin menaxhimi i sistemit të alarmit kundër vjedhjes dhe kundër zjarrit si dhe nderhyrja me verifikues të sistemeve të alarmit (grup i gatsuem), në institucionet publike ku ushtrojnë funksionet strukturat e Bashkisë Tiranë, si dhe në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor si një nga objektivat strategjike të programit të qeverisë për sigurinë në sistemin arsimor.

Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Sistem sigurie në sistemin arsimor: Arsimi parauniversitar është një ndër tre sektorët që zë më shumë peshë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës. Veç investimeve në çerdhe, kopshte dhe shkolla, bashkia synon edhe implementimin e një sistemi të integruar të shërbimeve nëpërmjet monitorimit me kamera të sigurisë dhe sisteme alarmi me qëllim rritjen e sigurisë në këto institucione.

Përveçse një aset në shkolla, implementimi i këtij sistemi është një detyrim i vazhdueshëm që vjen si pasojë e kërkesës nga institucionet përkatëse dhe organet kompetente për rendin dhe sigurinë publike në vend në funksion të mësimdhënies dhe mundëson qëllimin final, që janë ambientet të sigurta e të mbrojtura për fëmijët/ nxënësit e mësuesit.

Për një mbulim me shërbim të integruar sigurie për të gjitha institucionet e sistemit arsimor të territorit të Bashkisë Tiranë, janë planifikuar në këtë projekt institucionet arsimore të zonave urbane dhe interurbane.

Sistem sigurie në institucionet ku ushtrojnë funksionet strukturat e Bashkisë Tiranë:

Duke mbajtur në konsideratë një tërësi shërbimesh ndaj qytetarëve që ofrohen nga Bashkia Tiranë, si dhe referuar kërkesave të vazhdueshme lidhur me pajisjen me sistem sigurie për godinat

ku ushtrojnë funksionet strukturat e Bashkisë Tiranë, është planifikuar në këtë projekt përfshirja dhe mbulimi me sisteme sigurie për godinat ku ushtrojnë veprimtarinë institucione/ njësi organizative në varësi të Bashkisë së Tiranës.

PËRFITIMET E PROJEKTIT:

- Objektivi kryesor i përzgjedhjes së këtij shërbimi është krijimi i një sistemi të integruar sigurie në institucione të sistemit parashkollor dhe shkollor, si dhe disa institucione të tjera të Bashkisë Tiranë.

Nëpërmjet këtij shërbimi bëhet i mundur realizimi i:

- 1) Krijimi i sistemit të integruar të sigurisë me sisteme alarmi, reagim nëpërmjet grupit të gatshëm.
- 2) Detektimi dhe zbulimi në kohë reale të aktiviteteve të paligjshme, zjarreve si dhe ndërhyrjen e menjëhershme të Grupeve të gatshme.
- 3) Rregjistikimet e Monitorimit 24/7 gjatë gjithë vitit për parandalimin në kohë reale të ngjarjeve dhe situatave të paligjshme.
- 4) Ruajtja e të dhënave/ provave në databazën e serverit kur konstatohen shkelje sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
Udhezim Nr. 633, datë 6.11.2018 Per Përcaktimin e nivelit të masave të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo të vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre.

Nëpërmjet implementimit të një sistemi të sofistikuar sigurie, përfitojmë përmirësim të niveleve të sigurisë për të identifikuar e parandaluar rreziqet, ofrimin e një shërbimi të vazhdueshëm, përfundim të standardeve të shërbimit, rritjen e efikasitetit operacional dhe reduktimin të kostove. Institucionet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike kanë një referencë më shumë për rregjistikimin e pamjeve filmike të perfituara nga ky projekt dhe kjo është një masë që do të sjell jo vetëm përmirësimin e sigurisë si masë parandaluese në këto objekte ku do të montohen sistemet e integruara të sigurisë, instalimi i sistemeve të integruara të sigurisë ku ushtrojnë veprimtarinë struktura të Bashkisë Tiranë ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë në këto objekte dhe në parandalimin e ngjarjeve me karakter penal por në veçanti përmirësimin e sigurisë të arsimit parashkollor dhe shkollor, duke i shërbyer akoma më shumë cilësisë së mësimdhënies, sigurisë së ambientit, sigurisë së fëmijëve dhe natyrisht sigurisë mendore të prindërve të tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucionet e tjera të Bashkisë Tiranë”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit

Specifikimet teknike

Termet e referencës

NJËSIA E PROKURIMIT